



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-76762/22 dt. 06.04.2022, të kërkuësve / bashkëpronarëve, Shemsedin Klajiqi, Nexhmi Kastrati, Merlind Zhubi, Aza Hasanaj, Ismet Shkodra, Xhelal Roka, Ergjymet Mehmeti, Mixhait Reçi, Hasan Beselica, Fatmire Berisha, Astrit Mekuli, Bujar Surdulli, Shahindere Xhara nga Prishtina dhe Investitorit “Enerco LLC.”sh.p.k. nga Prishtina, dhe me përfaqësues / bashkëpronar, Shemsedin dhe Rinor Klaiqi nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesa “B”, të ndërtuara në kuadër të bllokut urbanistik “a_02”, të tërësisë urbane “A”, të Planit Rregullues “Muhaxhuret”, në rr. “Arkitekt Karl Gega” dhe “Qamile Jaka” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 01.06.2022, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET kërkuësve / bashkëpronarëve, Shemsedin Klajiqi, Nexhmi Kastrati, Merlind Zhubi, Aza Hasanaj, Ismet Shkodra, Xhelal Roka, Ergjymet Mehmeti, Mixhait Reçi, Hasan Beselica, Fatmire Berisha, Astrit Mekuli, Bujar Surdulli, Shahindere Xhara nga Prishtina dhe Investitorit “Enerco LLC.”sh.p.k. nga Prishtina, dhe me përfaqësues / bashkëpronar, Shemsedin dhe Rinor Klaiqi nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-76762/22 dt. 06.04.2022, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesës “B” me etazhitet 2B+S+P+8, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore..., 05 Nr. 351/02-52977/19 dt. 03.06.2019 dhe Vendim ndryshim-plotësimi i dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor të ndërtesës shumëbanesore & afarist-ndërtesa “B” me 2B+S+P+8, miratuar me Vendimin e lejes ndërtimore 05 NR. 351/02-52977/19 DT. 03.06.2019, 05 NR. 351/05-52977/19 DT. 06.12.2021, në parcelën kadastrale nr. 10259-0, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914059-10259-0, ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër të bllokut urbanistik urbanistik “a_02”, të tërësisë urbane “A”, të Planit Rregullues “Muhaxhuret”, në Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Arkitekt Karl Gega” ku ka dalje hyrjet me numrat: 40, 42, 44, dhe në rrugën “Qamile Jaka” ku ka dalje hyrjet me numrat: 16, 18, 20, 22, 24, dhe 26 në Prishtinë, dhe e njejta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Kërkuësit / bashkëpronarët, Shemsedin Klajiqi, Nexhmi Kastrati, Merlind Zhubi, Aza Hasanaj, Ismet Shkodra, Xhelal Roka, Ergjymet Mehmeti, Mixhait Reçi, Hasan Beselica, Fatmire Berisha, Astrit

Mekuli, Bujar Surdulli, Shahindere Xhara nga Prishtina dhe Investitorit "Enerco LLC."sh.p.k. nga Prishtina, dhe me përfaqësues / bashkëpronar, Shemsedin dhe Rinor Klaiqi nga Prishtina, me kërkesën 05 Nr. 391/02-76762/22 dt. 06.04.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën afariste & banesore, përkatësisht ndërtesës "B" me etazhitet 2B+S+P+8, e ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik "a_02", të tërësisë urbane "A", të Planit Rregullues "Muhaxhuret", në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10259-0 ZK Prishtinë, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore..., 05 Nr. 351/02-52977/19 dt. 03.06.2019 dhe Vendim ndryshim-plotësimi i dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor të ndërtesës shumëbanesore & afarist-ndërtesa "B" me 2B+S+P+8, miratuar me Vendimin e lejes ndërtimore 05 NR. 351/02-52977/19 DT. 03.06.2019, 05 NR. 351/05-52977/19 DT. 06.12.2021, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit, e Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-1405/22 dt. 30.03.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuarit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografitë gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Ermal Buçinca; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Jeton Canhasi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Ermal Daka; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Asmir Hamdi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Rasim Mjekiqi; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Edona Sheqerolli me nr. të licensës 101;

Drejtoria e Urbanizmit, pas pranimit të kësaj kërkesë dhe shqyrtimit të saj, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, përmes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-76762/22 DT. 01.06.2022**

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu
B.Vllasaliu

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi
N.Krasniqi

Drejtori,
Arber Sadiki
A.Sadiki



